



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 15

Prishtinë, më 28.3.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Gaxherri, Driton Çausi, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Ganimete Musliu, Enver Hoti, Salih Salihu.

Munguan : Daut Haradinaj, Sergjan Mitroviç, Liburn Aliu, Danush Ademi.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Besa Gaxherri**, nënkryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Shqyrtimi i çështjes së kualitetit të mishit dhe prodhimeve nga mishi, i ftuar kryeshefi i AUV, z. Valdet Gjinovci.**

Nënkryetarja Besa Gaxherri, hapi mbledhjen dhe përshëndeti kryeshefin e AUV-së, me stafin përcjellës, duke hyrë në temën, siç e quajti ajo, skandalin me importin e mishit pa afat dhe jashtë kontrollit institucional në Kosovë. Para se t'ua japë fjalën zyrtarëve të AUV-së, ajo për fillim i formuloi pyetjet rreth mishit: Pse pa afat, nga kush është importuar? Kush janë inspektuesit e mishit të tillë? Çfarë masash janë ndërmarrë? Më tutje, anëtarët e komisionit do të vazhdojnë me pyetjet shtesë.

Valdet Gjinovci, përshëndeti iniciativën e komisionit për këtë takim dhe ngritjen e vetëdijes së deputetëve për këtë çështje të rëndësishme, ngase kërkohet angazhimi institucional. Fillimisht, njoftoi komisionin me kapacitetet që posedon kjo agjenci (71 inspektorë, numër ky i plotësuar edhe nga 37 komuna të Kosovës dhe shënime tjera, të cilat ai tha se do t'ia dërgojë me shkrim komisionit) dhe kërkesën zyrtare të AUV-së që nga periudha 2010-2018 për transferim të inspektorëve në këtë agjenci, i cili transferim, fatkeqësisht ende nuk ka ndodhur. Ai i siguroi anëtarët e komisionit se deri më tani nuk ka pasur importim të mishit të prishur dhe potencoi rastet kur është hasur me mish të tillë dhe si është vepruar (viti 2004, rasti i Belgjikës, viti 2016 etj.) dhe janë lajmëruar menjëherë organet hetimore, ndaj edhe nga komisioni kërkoi që të tregohen faktet dhe rastet, nëse ka argumente.

Besa Gaxherri, ndërhyri dhe shprehu habinë, duke pyetur d.m.th. në Kosovë nuk ka fare mish të importuar me afat të skaduar. Ajo u fokusua në pyetjen : Cilat janë ato kompani që importojnë dhe njëherësh janë nën kontroll të AUV-së.

Kryeshefi, në këtë pyetje reagoi duke sqaruar se AUV lëngon nga mungesa e inspektorëve, siç potencoi në fillim. Përndryshe, edhe një herë reagoi se çdo prodhim i pa afat, menjëherë asgjësohet.

Driton Çausi i parashtrori disa çështje dhe potencoi rëndësinë e veçantë të kësaj teme, ngase siç tha ai, në botë 70% të sëmundjeve tek njerëzit burimin e kanë tek ushqimi me prejardhje shtazore nga kafshët. Ai u fokusua sidomos në sëmundjen tani në rritje të tuberkulozit të gjedhit dhe pyeti për kontrollet dhe analizat e mostrave sa bëhen etj., sëmundjet nga shpezët (pulat dhe zogjtë) dhe helmimet nga ato. Si është e mundur që u zbulua nga skandali i Belgjikës 40.000 tonë mish jashtë afati me ndihmën e inspektorëve komunalë dhe çka veprohet në Kosovë në baza ditore, nëse i kemi këto të dhëna, a ka ndonjë rregullore për aditivët dhe sa është limiti i përdorimit të tyre? Po ashtu, për therjet etj.

Enver Hoti, reagoi në fjalën hyrëse të kryeshefit, i cili tha se është ngritur vetëdija e deputetëve dhe potencoi se deputetët gjithmonë e kanë pasur vetëdijen e ngritur dhe kjo është një lojë fjalësh, e cila nuk mund të tolerohet, kurse arsyet pse AUV nuk i kryen obligimet e veta, ajo është për t'u diskutuar. Në ditët e sotme, kur kemi çdo lloj sëmundjesh nga ushqimi me afat të skaduar, vazhdoi, AUV sa kohë përsërit retorikën që nuk posedon kapacitetet e nevojshme, mirëpo në anën tjetër, dyshimet shtohen se kush dhe çka punon në këtë agjenci. Poashtu, ka mosbashkëpunim nga ana e AUV-së. Ai parashtrori pyetjen : Sa importues mishi ka Kosova dhe si e sa janë rezervat e tyre, si bëhet shpërndarja? Përkundër vështirësive dhe mungesave që ka, AUV duhet të rrisë aktivitetin, ngase kaq nuk mjafton.

Salih Salihu, theksoi se nuk përputhen konstatimet e kryeshefit, i cili në njërin anë thotë se nuk ka mall me afat të skaduar, kurse në anën tjetër, nëpër qytetet tona (Prizren, Rahovec etj.), çdo ditë zbulohen me qindra e mijëra tonë mish me afat të skaduar, kurse nëpër lajme shohim si po asgjësohen, andaj pyeti : Si është e mundur të kemi 350 mostra në vit dhe kush duhet të përgjigjet në këto raste? Ai solli edhe fakte numerike, sa hyn në vendin tonë mall, ushqim të skaduar, por mungojnë analizat, potencoi edhe bletarinë e cila fushë është pa asnjë analizë, nga OMGJ, hormonet për viça, tharja e mishit dhe suxhukut, duke ndezur gommat etj., me një fjalë, në Kosovë, kemi shpalljen e luftës biologjike ndaj popullatës, kurse kjo agjenci e cila me rëndësi ia kalon edhe AKI-së, nuk vepron ose shumë pak vepron.

Andin Hoti, nuk përsëriti vërejtjet shumë me vend të parafolësve, andaj u fokusua në mbajtjen e higjienës nëpër mishtore dhe furra, duke potencuar disa shembuj të papastërtisë totale nëpër lokalet dhe depo anembanë Kosovës, andaj pyeti kjo: “vrasje ndaj popullatës”, si do të ndalohej dhe çka konkretisht ndërmeret AUV dhe si është e mundur që te një kompani të gjendet parregullsi totale, pastaj ajo kompani prapë të vazhdojë me punë, si mundet Kuvendi, përkatësisht ky komision, ta ndihmojë AUV-në?

Ganimete Musliu, gjithashtu pajtohet me vërejtjet që u dëgjuan nga parafolësit, por edhe përgëzoi AUV-në për sukseset, sidomos me parandalimet që ka pasur me rastin e Belgjikës, gjatë vitit 2016, mirëpo siç tha ajo, nuk mund të pajtohem me gjendjen ekzistuese që nuk mund të mbrojmë sa duhet industrinë, ngase me këto veprime dëmtohen prodhuesit e ndershëm. Ajo parashtrori pyetjen: Çka ka ndërmarrë AUV ndaj kompanive që dihen publikisht se kush janë, kush është ai që ka kërkuar importin, a ka ndonjë penalizim apo padi ndaj ndokujt? **Lutfi Zharku** pyeti për rastin Jupa, a është i lidhur arrestimi i tij me çështjen e mishit të prishur.

Kryeshefi z. Gjinovci, në vazhdim u fokusua në pyetjet më kryesore, siç tha, ngase janë gjëra shumë domethënëse, të cilat kërkojnë vëmendje të saktë, andaj në fillim potencoi disa shifra për mostra dhe inspektime, por përsëriti kërkesën rreth transferimeve të inspektorëve, pa të cilët kjo agjenci nuk mund të mendohet, kurse thertoret, shumica janë ende tradicionale nëpër fshatra, ato

zyrtare dihet si funksionojnë, d.m.th. në këtë drejtim nuk ka përparim, ngase therjet më të mëdha bëhen nëpër tregje dhe pa kontroll, p.sh. Prishtina tregun e ka në periferi.

Driton Çausi, ju na tregoni për thertore të licencuara.

Kryeshefi tha se janë shënime elektronike, mirëpo përfaqësojnë 5050 therje në vit, kafshët raportohen në sistem, por jo edhe therjet. Ato thertore të organizuara rregullisht raportojnë, vaksinimi dhe veprimet tjera që duhen të bëhen nuk janë në nivelin e kënaqshëm.

Driton Çausi, pyeti : Si mund të lihen punët e mëdha punëtorëve me kaq numër të vogël, sepse p.sh. çdo lopë duhet të kontrollohet para therjes dhe pas therjes, dhe çka ndodhë me mbeturina? (Kryeshefi theksoi se MMPH i cakton deponitë ku duhet të dërgohen).

Lidhur me pyetjen e z. Andin, **Flamur Kadriu** u përgjigj se nuk ka limit për përdorimin e **aditivëve**. Gjithashtu, OMGJ nuk janë në kompetencën e AUV-së, kurse rreth higjienës, tha se çdo operator është i kategorizuar se sa dhe si duhet të mbajë higjienën.

Para se të përmbyllë mbledhjen, kryesuesja, kryeshefi ftoi komisionin të vizitojë AUV-në, edhe pse pranoi se komisioni ishte në janar në këtë agjenci, kurse sot i ftoi të gjithë anëtarët, mirëpo **Driton Çausi** potencoi se nuk kërkoi vizitë, por fakte dhe shënime. Edhe disa anëtarë tjerë kërkuan fjalën.

Besa Gaxherri, kryesuese, duke konstatuar se me këtë mbledhje as për së afërmi nuk është përthekuar ajo që dëshiroi komisioni, kërkoi nga zyrtarët e AUV-së, që t'udrejtohen me shkrim këtë komisioni, për të gjitha pyetjet që u dëgjuan këtu dhe që kanë arritur të shënojnë këta zyrtarë, në mënyrë që **të dalë ky komision para qytetarëve dhe të zbardhë përfundimisht enigmën se çka është duke ndodhur me AUV-në ose përgjithësisht me ushqimin në Kosovë.**

VËREJTJE: Në procesverbal nuk janë shënimet, sidomos ato profesionale të diskutuara në mes Driton Çausit dhe Flamur Kadriut, ngase siç u kërkua nga AUV, ato duhet të dërgohen me shkrim dhe me saktësi, që u kërkuan nga deputetët e lajmëruar për diskutim.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryesuesja e komisionit,

Besa Gaxherri